

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – PUNË NR. 1

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstrukcion i godines dhe oborrit te shkolles 9 vjecare "Avni RustemI”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- 45214220-8 - Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare,

LLOJI I PROCEDURËS:

Procedurë e hapur elektronike - Pune.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- Fondi limit i kontratës: **108,776,265.00 lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Referuar nenit 39, te Vkm Nr. 285, date 19.005.2021 “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik, per Kontrata me celesa ne dore, percaktojme se kjo procedure publike do te jete “me kontratë me çelësa në dorë:

- i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.
Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2 dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA TEPELENE, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER PROJEKTUESIN

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12(shërbime konsulence)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

1. Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, sipas kësteve, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operoret ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Liçensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategorite:

Kat. 1 c -Plane të detajuara vendore

Kat. 2. PROJEKTUES ARKITEKT

b-2) Objekte arsimore;

c- Projektim interiere;

d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberta, lulishte e parqe.

Projektuesi arkitekt nevojitet për realizimin e projektit arkitektonik, për objektin arsimor të llojit shkolle, i cili në konceptimin e vet do të ketë edhe realizimin e projektit të ndërtimeve si dhe peisazhit të sipërfaqeve të gjelberta në hapësirën e jashtme të objektit.

Kat . 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

b) 1.Objekte civile -industriale - turistike mbi 5 kate -2. objekte me skelet melali

c) Projektim: 1. Objekte me shkalle te larte veshtiresie Beton-arme-metalike -2. troje dhe shpate me qendrushmeri le ulel;

.Projektuesi konstruktor nevojitet per kete objekt nen 5 katesh me nje kompleksitet nderhyrjesh perforcuese ne strukturen e vet te jete i amortizuar si nje objekt ekzistues i me shume se 40 viteve, nga ndertimi i tij me nje cilesi jo te mire, duke u bere nderhyrje perforcuese ne themele, ne muratura dhe ne mbulesa. Po ashtu do te ndertohen dhe konceptohen fusha sporti me konstruksion metalik te perbere, me hapsira te konsiderueshme.

Kat. 4. PROJEKTUES INSTALATOR

a) Projektim te instalimeve hidro-termosanitare;

b) Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme

c) Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale;

d) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;

e) Projektimi i impianteve ngritese e transportuese (ashensore, shkalle levizese, etj.);

f) Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale.

Projektuesi instalator do te duhet te konceptoje dhe te realizoje te gjitha sistemet nga kondicionimi, mbrojtja kundra zjarrit, shkalle qarkulluese, sistemin e dedektimit dhe network. Duke qene se objekti ekzistues nuk ploteson kushtet optimale me standartet e kerkuara, lind nevoja per realizimin tyre nga fillimi.

Kat. 5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

Projektuesi hidroteknik nevojitet per sistemin e drenazhimit te jashtem, te oborrit me nje siperafeqe te konsiderueshme ne lidhje edhe me infrastrukturen rrugore ekzistuese, gjithashtu edhe per sistemin e MKZ dhe nyjeve sanitare ne objektin ekzistues, te cilat do te rikonceptohen sipas standarteve optimale.

Kat.8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike
- b) Rilevime inxhinierike kadastrale
- c) Sistemet GIS
- d) Bazamente gjeodezike
- e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik

Projektuesi gjeodet nevojitet per te azhornuar gjendjen ekzistuese te kuotave te sheshit dhe venien ne dispozicion te projektuesve per pershtatjen sipas projektit qe do te realizohet per zbatim te kontrates,

Kat. 9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.

Projektuesi gjeolog nevojitet per te bere sondazhin e themelit dhe sheshit te cilet sipas studimit do te behet nderhyrja nga projekti konstruktor per perforcimin e struktures dhe struktura perimetrare te objektit dhe sheshit.

Kat. 10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

Projektuesi elektrik nevojitet per vlersimin dhe kthimin ne nje dhome teknike te rrymes elektrike dhe ndarjen e tyre sipas standarteve optimale duke vlersuar projektin e ri i cili nuk do te kete ngjashmeri me ate ekzistues duke qene se ketu do te rriten fuqite per shkak te implementimit te shume sistemeve te rinje dhe kualifikimin dhe shtimit te ambjenteve sportive me ndricim etj.

Kat. 12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

- a) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

Kjo kerkese e licenses duhet per te hartuar raportin sizmiologjik te objektit qe do te ndertohet duke vene ne dispozicion raportin projektuesit konstruktor per te bere nderhyrjet e nevojshme dhe kthimin e objektit te amortizuar ne nje objekt te qendrueshem ne raport me sizmicitetin e zones.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr. 943, datë 28.12.2016”.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me Termat e Referencës..

3. Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik ne Licensen e Shoqerise stafin si më poshtë dhe te jenë te perfshirë ne listpagesën e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar:

- 2 Arkitekt;

- 2 Inxhinier Ndertimi

- 1 Inxhinier Hidroteknik;

- 1 Inxhinier Gjeodet;

- 1 Inxhinier Gjeolog

- 1 Inxhinier Elektrik;

- 1 Inxhinier Mekanik

- 1 Inxhinier Mjedisi I pajisur me certificate lëshuar nga Agjencia për Eficensën e Energjisë për Menaxhim Energjie;

Per stafin e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë,CV .

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Për përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar dhe deklaratat e disponueshmerise te stafit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Sic u permend edhe ne argumentimin e pikave licenses Arkitektet, Inxh Ndertimi, Inxh Hidroteknik, Inxh Gjeodet, Inxh Gjeolog, Inxh Elektrik, Inxh Mekanik, jane te nevojshem per te dhene ekspertizen e tyre profesionale per realizimin e te gjitha hapave te projektit te zbatimit.

Referuar inxhinierit te mjedisit i certifikuar me certificate lëshuar nga Agjencia për Eficensën e Energjisë për Menaxhim Energjie energjisë vlerëson dhe menaxhon se si energjia do te përdoret në një objekt arsimor me shume sisteme, si ngrohje ftohje, VRF, inverter, etj duke menaxhuar ngrohjen dhe ftohjen ne ambientet ku eshte e nevojshme, ne kohen e nevojshme dhe rregullator I temperatures Brenda ambienteve te ambientit kur at jane me teper apo me pak nga teperatura e percaktuar ne pajisje, identifikon mundësitë e ruajtjes së energjisë dhe bën rekomandime se ku mund të reduktohet ose optimizohet konsumi i energjisë. Audituesi per menaxhimin e energjise në ndërtesa ofron njohuritë themelore të nevojshme për të vlerësuar se si përdoret energjia në një objekt dhe për të identifikuar se ku mund të reduktohet konsumi. Për më tepër, ai mbulon metodologjitë e dobishme të llogaritjes përmes shembujve praktikë dhe skenarëve të mundshëm kompjuterik. Gjithashtu ben qe sistemi I ndricimit te zgjidhet teknologjia e LED. Po ashtu edhe ne termoizolimn e fasades dhe mbuleses duke reduktuar disa fish konsumin e energjise.

Inxhinieri i mjedisit nevojitet per perlllogaritjen dhe plan menaxhimin te mbejtjeve te ngurta duke perdorur teknikat me uje dhe transportin e tyre ne kushtet e duhura. Gjithashtu dhe ne perzgjedhjen e sistemim gjelberimit duke zgjedhur gjelberimin e duhur, pershtatjen e tij me klimen dhe zonen dhe tipologjine e projektit.

4. Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës ku te figurojne 3 muajt e fundit ne listepgaesa,si më poshtë:

- 3 Arkitektë;

- 2 Inxhinierë Ndërtimi Profili Strukturist; ku njeri te jete Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa
- 1 Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf
- 1 Inxhinier Hidroteknik;
- 2 Ekspert Zjarrëfikës;
- 2 Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.
- 2 punonjës i pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- 2 punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 punonjës i pajisur me certifikatë për përgjegjës dhe administrimin e mbrojtjes në mjedis.

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Për përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar dhe deklaratat e disponueshmerise te stafit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Sic u permend edhe ne argumentimin e pikave licenses edhe stafi mbeshtetes, eshte i nevojshem per te dhene ekspertizen e tyre profesionale per realizimin e te gjitha hapave te projektit te zbatimit, duke qene se objekti arsimore eshte nje objekt dhe shkolla kryesore me nje numer te larte nxenesish dhe mese i nevojshem per vitin e ardhshem arsimore, eshte shume e rendesishme qe projekti te realizohet ne nje kohe te shkurter, per te vijuar me zbatimin e punimeve te ndertimit ne menyre te menjehershme, duke mos anashkaluar edhe rendesine e nje projekti te plote. Kjo i verteton AK se operatori ekonomik ka ne kapacitetet e tij nje staf te kualifikuar dhe te konsiderueshem i cili mund te realizoje kontraten ne kohe.

Referuar Audituesit energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa energjise, vlereson dhe auditon se si energjia do te perdoret ne nje objekt arsimor me shume sisteme, si ngrohje ftohje, VRF, inverter, etj duke audituar ngrohjen dhe ftohjen ne ambientet ku eshte e nevojshme, ne kohen e nevojshme dhe rregullator I temperatures Brenda ambienteve te ambientit kur ato jane me teper apo me pak nga teperatura e percaktuar ne pajisje, identifikon mundesite e ruajtjes se energjise dhe ben rekomandime se ku mund te reduktohet ose optimizohet konsumi i energjise. Audituesi i energjise ne ndertesat ofron njohuritë themelore te nevojshme per te vleresuar se si perdoret energjia ne nje objekt dhe per te identifikuar se ku mund te reduktohet konsumi. Per me tepër, ai mbulon metodologjitë e dobishme te llogaritjes permes shembujve praktikë.

Persa i perket punonjësve te pajisur me çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" eshte e detyrueshme ne zbatim te Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe

shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Referuar punonjësve të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,dhe punonjës i pajisur me certifikatë për përgjegjës dhe administrimin e mbrojtjes në mjedis AK garanton ne kete menyre se do te realizohet plani i organizimit te mbejeve, metodologjine e prihsjeve dhe reduktimin te pluhrave me teknikat me uje, ndotjes akustike dhe rrethimit te kaniterit, ngritjes se tij duke qene se nddhet ne nje zone te banuar me nje numer te larte banoresh dhe institucinet perreth.

Referuar eksperteve zjarrfikese nevojitet per planifikimin dhe projektimin e sistemeve kundra zjarrit dhe vendosjen e tyre ne vende te caktuara ne objekt .

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te References. Kriteri per stafin, lidhet ngushtesisht me objektin e kontrates. Nevoja per keta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

5.Një listë të personelit kryesor dhe stafit mbështetës ku të specifikohen emrat dhe profili , që do të angazhohen në këtë objekt prokurimi.

6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 25 (njezet e pese) punonjës për 3 muajt e fundit të deklaruar, të vërtetuar me:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen e fundit të deklaruar

b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhen e fundit të deklaruar.

Për përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatorët ekonomik të kualifikuar të fazes së parë (lista e shkurtër), duhet të dorëzojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet të paraqitura në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur **bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References.**

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje 3 muajt e fundit tregojnë besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

7.Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme ose ekuivalentet e tyre per objektin e prokurimit si me poshte:

a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;

b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;

c) ISO 18001-2007, ekuivalente me ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;

d) ISO 50001-2011, Sistemi i Menaxhimit të Energjisë;

e) PAS 99:2012, Sistemi i Menaxhimit të Integruar

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikëqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet..

8.Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 2(dy) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;

- 2(dy) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12 ku të deklarohet disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMI PER NDERTIMIN

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1*
- b) *Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2*
- c) *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*
- d) *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Vendimi nr.3 datë 09.06.2021 “Për miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra, **punë**, shërbime për procedurën e prokurimit "procedurë e hapur”

ç. Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas shtojcës 2.

d. Preventivat e punimeve, sipas shtojcës 10

Për procedurën me objektin e sipërpërmendur është përzgjedhur Kriteret i vlerësimi të fituesit bazuar në Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore gjatë tre viteve 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.Për

plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga dega e Tatim-Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-Albania.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe në pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Përcaktimi i viteve (3 vitet e fundit financiar) të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për tre vitet 2020, 2021 dhe 2022 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt - Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetem kur janë në kushtet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, kreu V, neni 41, pika c.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të

Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.3 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2023, në të gjitha adresat ku operatorët ekonomik kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do të kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mësipërm.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, si dhe nenit 39, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri i pikës 2.2.3 u vendos në referencë te nenit 76, pika 2 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe u vlerësua në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe konkretisht në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, Taksat Vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës, me qëllim që fituesi i mundshëm të jetë në gjendje për të zbatuar në mënyrë sa më korrekte kontratën.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 4, të VKM-se Nr. 285, datë 19.5.2021:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës të fondit limit, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga momenti i prokurimit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të Lotit që prokurohet.

*** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në këtë bashkim.

Në rastin kur operatorët ekonomikë anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtem:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike:
- Kontratë sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar
 - Aktin e kolaudimit (në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e përkohshme të marrjes në dorëzim
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës Nr. 9

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat:
- Kontrate sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar
 - Aktin e kolaudimit (në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)
 - Vërtetim lëshuar nga subjekti privat, për kryerjen me sukses të kontratës
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë përveç dokumentacionit të mësipërm, edhe:

- *Kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit*

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë përvec dokumentacionit të mësipërm, edhe:

- *Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.*
- *Miratimin zyrtar si nënkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 39, pika 5/a dhe b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt që prokurohet, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, ne baze te VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

(a) Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P–1 A Punime gërmimi në tokë;
- N.P–2 B Ndërtime civile e industriale;
- N.P–3 D Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash;
- N.P–4 A Punime në rrugë, etj.;

· N.P-12 C Punime të inxhinierisë së mjedisit.

(b) Për punimet speciale të ndërtimit:

(1) N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve;

(2) N.S-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;

(3) N.S-4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;

(4) N.S-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;

(5) N.S-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;

(6) N.S-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;

(7) N.S-18 C Punime topogjeodezike.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit

dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licenca/leje, lëshuar nga institucionet kompetente si më poshtë: III.2.B Licencë për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazininim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimit Nr.42, datë 16.2.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës.

Kategoritë dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të preventivit, dhe janë si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen në kryhen në preventive që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli I klasifikimit I kërkuar për kategorinë respective më milionë lekë	Vlera e punimeve që parashikohen në kryhen në preventive, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gjurmimi në tokë	Punime dhe	0-20	306204
NP-2 B	Ndërtime civile dhe Industriale	Punime betoni dhe B/A; ambiente sportive ,Punime murature	20-50	23.502.989
NP-3 D	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash	Shuma totale e ndërtimit	101-200	108776265
N.P-4 A	Punime në rrugë	Sistemi I ambienteve të jashtme	0-20	8000000
NP-12 A	Punime të inxhinierise se Mjedisit	15% e shumës totale të ndërtimit	0-20	16316439
NS-1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Punime prishje	0-20	5705563
NS-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre	Sistemi furnizimit me uje dhe shkarkimit;	0-20	973000

NS-4 B	Punime rifinature te muratures dhe te lidhura me to, rifinature me materiale druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifinature te natyres teknike ndertuese)	Punime rifiniture te brendshme	20-50	29490764
NS-12 A	Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit	Impjante teknologjike	0-20	16853307
N.S - 13 A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunicacioni	Instalimi rrjeti data	0-20	665500
NS-14 A	Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv etj	Instalime elektrike	0-20	16172365
NS-18 A	Punime Topogjeodezike	15% e shumës totale të ndërtimit	0-20	16316439

Kategoria NP-1 A (Punime gjermimi në tokë)

Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kategoria (Ndërtime civile dhe Industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kategoria NP-3 D (Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash)

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kategoria N.P-4 A Punime në rrugw

Punime në rrugë, etje

Konsiderohen ndër të tjera rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Kategoria NP-12 A(Punime te inxhinierise se Mjedisit)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik.

Referuar zerave te preventivit kemi te bejme me punime germimi, ndertimi, heqje dherash etj, qe kane ndikim negativ ne mjedisin perreth. Gjate zbatimit te projektit ne realizimin e plote te kontrates, eshte e pashmangshme qe ne realizimin e punimeve te kete mbeturina e inerte te cilat jane te nje rrezikshmerie te larte per komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet te realizohet ne perpikmeri dhe ne kohe reale.

Kategoria NS-1 A (Punime per prishjen e ndertimeve)

Konsiderohet çmontimi i impianteve industrial dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje special ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Referuar zerave te preventivit kemi punime prishje të rifinituara, mureve, trotuareve, rrugës, bordurave etje, ku kontraktuesi duhet te marre masa qe te mbroje godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat qe gjenden ne afersi te objektit, ku po kryhen keto punime prishese. Per kete, duhen evituar mbingarkesat nga te gjitha anet e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshte, duhet pasur kujdes qe te parandalohet shperndarja ose renia e materialeve, ose te projektohet ne menyre te tille, qe mos te perbeje rrezik per njerezit, strukturat rrethuese dhe pronat publike te çdo lloji.

Kategoria NS-2 A (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturimi impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundërzjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kategoria NS-4 B (Punime rifinature te muratures dhe te lidhura me to, rifinature me materiale druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifinature te natyres teknike ndertuese)

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdolloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipave të ndryshme.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve të cilat përfshijnë të gjithë zerrat e përmendur me sipër duke përfshirë dhe punimet e përfundimit të godinës.

Kategoria NS-12 A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Kategoria N.S - 13 A (Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni)

Konsiderohen montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kategoria NS-14 A (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv etj)

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Kategoria NS-18 A (Punime Topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike special që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale geodezike; rrjeta

Në këtë objekt përfshihen edhe punime si piketimi, rilevime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhurnime të ndryshme dhe lidhjet me sistemet koordinative relative dhe absolute.

III.2.B - Licencë për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme”

Kërkesa për disponimin e licencës III.2.B - Licencë për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme” është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe lidhet me standartet e menaxhimit mjedisor Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë licensat profesionale të domosdoshme për kryerjen grumbullimin e ruajtjen dhe transportimin embetjeve ne kantie

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar stafin inxhinierik si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Topograf
- 2 (dy) Arkitekt
- 1 (një) Mjedis I pajisur me certificate lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë për Menaxher Energjie
- Inxhinier elektronik

Per stafin e me siperm subjekti duhet te paraqesi keto dokumenta:

- Listepagesat e deklaruar ne organet tatimore bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve”.
- Kontrate pune te vlefshme gjate periudhes se ekzekutimit te kontrates.
- Diplomat perkatese
- CV-ja.
- stafi i mesiperm duhet domosdoshmërisht të jete i përfshirë në listëpagesat e OE, minimalisht në 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave;

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8 ku të deklarohet disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Sic u përmend edhe ne argumentimin e pikave licenses stafi i drejtuesve teknik eshte i nevojshem per te dhene ekspertizen e tyre profesionale per realizimin e te gjitha hapave te projektit te zbatimit.

Referuar inxhinierit te mjedisit i certifikuar me certificate lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë për Menaxhim Energjie energjisë vlerëson dhe menaxhon se si energjia do te përdoret në një objekt arsimor me shume sisteme, si ngrohje ftohje, VRF, inverter, etj duke menaxhuar ngrohjen dhe ftohjen ne ambjentet ku eshte e nevojshme, ne kohen e nevjshme dhe rregullator I temperatures Brenda ambjenteve te ambjentit kur at jane me teper apo me pak nga teperatura e percaktuar ne pajisje, identifikon mundësitë e ruajtjes së energjisë dhe bën rekomandime se ku mund të reduktohet ose optimizohet konsumi i energjisë. Audituesi per menaxhimin e energjise në ndërtesa ofron njohuritë themelore të nevojshme për të vlerësuar se si përdoret energjia në një objekt dhe për të identifikuar se ku mund të reduktohet konsumi. Për më tepër, ai mbulon metodologjitë e dobishme të llogaritjes përmes shembujve praktikë dhe skenarëve të mundshëm kompjuterik. Gjithashtu ben qe sistemi I ndricimit te zgjidhet teknologjia e LED. Po ashtu edhe ne termoizolimin e fasades dhe mbuleses duke reduktuar disa fish konsumin e energjise.

Inxhinieri i mjedisit nevojitet per perllogaritjen dhe plan menaxhimin te mbejtjeve te ngurta duke perdorur teknikat me uje dhe transportin e tyre ne kushtet e duhura. Gjithashtu dhe ne perzgjedhjen e sistemim gjelberimit duke zgjedhur gjelberimin e duhur, pershtatjen e tij me klimen dhe zonen dhe tipologjine e projektit

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar me kohe te plote në stafin e vetë punonjës me profesionet si më poshtë :

- Jo me pak se 2 (dy) punonjes per montim riparim dyer dritare

Keto punonjes nevojiten per montimin e dritare dhe dyerve te aluminit dhe dyerve te drurit.

- Jo me pak se 3 (tre) punonjes hidraulik

Keto punonjes nevojiten per punimet hidraulike te furnizimit dhe shkarkimit te ujit ne godine. Gjithashtu edhe per montimin e impjantit MNZ.

- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Montim / Riparim kaldaje

Keto punonjes nevojiten per montimin e kaldajes dhe radiatoreve te ngrohjes.

- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Parketshtues

Keto punonjes nevojiten per shtrimin e parketit ne palester.

- Jo më pak se 4 (kater) punonjës Suvatues

Keto punonjes nevojiten per suvatimin e godines nga jashte dhe nga Brenda.

- Jo më pak se 4 (kater) punonjës Bojaxhi

Keto punonjes nevojiten per lysterjen e godines nga jashte dhe nga Brenda.

- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Elektrik

Keto punonjes nevojiten per te bere instalimin e kabujve, ndricuesve, Celsa, priza etj.

- Jo më pak se 3 (tre) punonjës Saldator

Keto punonjes nevojiten per te kryer punimet e saldimit per shkallen e emergjences dhe kapriates metalike ne palester.

- Jo më pak se 3 (tre) punonjës pllakashtrues

Keto punonjes nevojiten per te shtrimin e pllakave ne godine.

- Jo më pak se 3 (tre) punonjës murator

Keto punonjes nevojiten per te ndertuar muret e reja ne godine.

- Jo më pak se 3 (tre) punonjës karpentier

Keto punonjes nevojiten per ndertimin e mureve te betonit, brezave, themeleve etj.

- Jo më pak se 2 (dy) punonjës Teknik ndertimi

Keto punonjes nevojiten per te ndihmuar drejtuesin Teknik dhe specialistet e ndertimit per punimet e ndertimit.

- Jo më pak se 1 (nje) punonjës Teknik mekanik

Ky punonjes nevojitet per te ndihmuar drejtuesin Teknik dhe specialistet mekanik per punimet mekanike.

- Jo më pak se 1 (nje) punonjës Teknik hidraulik

Ky punonjes nevojitet per te ndihmuar drejtuesin Teknik dhe specialistet hidraulike per punimet hidraulike.

- Jo më pak se 1 (nje) punonjës Teknik topograf

Ky punonjes nevojitet per te ndihmuar drejtuesin Teknik per punimet topografike.

- Jo më pak se 1 (nje) punonjës Hidroizolues

Ky punonjes nevojitet per te kryer punimet e hidroizolomit ne tualete dhe tarraca.

Për profesionet si më sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemri i punonjësit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT(Në rast se lëshuesi është institucion privat)

Për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet që operatorit ekonomik, duhet të paraqesë për punonjësit specialist si dokumente provues: kontratë pune të vlefshme, dëshmi kualifikimi /certifikatë dhe/ose diploma, të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucionet publike/private të licencuara sipas ligjir nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH, I ndryshuar,si dhe të figurojnë në listpagesat me kodet sipas ligjit”, sipas Ligjit Nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe Ligji Nr. 13/2013, për periudhën 3 muajt e fundit.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8 ku të deklarohe disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Persa i perket punonjesve te certifikuar profesionale, AK i ka kerkuar pasi jane pike kyce ne realizimin e punimeve te objektit. Gjithashtu jane edhe stafi i cili do te udhëhiqet nga drejtuesit teknik sipas profesioneve per te kryer punimet ne objekt.

4. Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete si staf mbështetës si më poshtë:

- 2 Arkitektë;
- 1 Inxhinier Gjeoteknik
- 1 Inxhinierë Ndërtimi Profili Strukturist Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa ;
- 2 punonjës i pajisur me certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- 2 punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 punonjës i pajisur me certifikatë për përgjegjës dhe administrimin e mbrojtjes në mjedis.

Per punonjësit e mesiperm Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

Kontratat individuale te punes (të vlefshme), Diplomë, CV, si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit, nga data e hapjes se tenderit.

Operatori/ët Ekonomik, duhet të paraqes sipas formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 në DST, të ketë pjesë të stafit të tij, të paktën 1 (një) ekspert të pajisur me Çertifikatën “Ekspert në fushën e mbrojtjes nga zjarri (MNZ) dhe shpëtimit”, i cili, duhet të figurojë i punësuar me kohë të plotë në listpagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit.

Për ekspertin të paraqitet, kontratë pune (e vlefshme), Çertifikata për ushtimin e profesionit si ekspert privat zjarfikës si dhe licensa e lëshuar nga QKL.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë (*sipas shtojcës 8 të DST*) se ka të punësuar minimalisht **3 (tre) (manovratorë)** dhe **4 (kater) shofera**, për periudhën tre muajt e fundit **nga data e hapjes se tenderit.**

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik, duhet të paraqes kontratat e punës të (vlefshme), Dëshmi e Aftësisë Profesionale D.A.P (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse.

Per stafin e me siperm subjekti duhet te paraqesi keto dokumenta:

- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve”.
- Kontrate pune te vlefshme gjate periudhes se ekzekutimit te kontrates.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12 ku të deklarohet disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Stafi mbështetës, është i nevojshëm për të dhënë ekspertizën e tyre profesionale për realizimin e të gjitha hapave të projektit të zbatimit, duke qenë se objekti arsimor është një objekt dhe shkolla kryesore me një numër të lartë nxënësish dhe mëse i nevojshëm për vitin e ardhshëm arsimor, është shumë e rëndësishme që projekti të realizohet në një kohë të shkurtër me zbatimin e punimeve të ndërtimit në mënyrë të menjehershme, duke mos anashkaluar edhe rëndësinë e një projekti të plotë. Kjo i vërteton AK se operatori ekonomik ka në kapacitetet e tij një staf të kualifikuar dhe të konsiderueshëm i cili mund të realizojë kontratën në kohë.

Referuar Audituesit energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa energjisë, vlerëson dhe auditon se si energjia do te përdoret në një objekt arsimor me shume sisteme, si ngrohje ftohje, VRF, inverter, etj duke audituar ngrohjen dhe ftohjen ne ambjentet ku eshte e nevojshme, ne kohen e nevojshme dhe rregullator I temperatures Brenda ambjenteve te ambjentit kur ato jane me teper apo me pak nga teperatura e percaktuar ne pajisje, identifikon mundësitë e ruajtjes së energjisë dhe bën rekomandime se ku mund të reduktohet ose optimizohet konsumi i energjisë. Audituesi i energjise në ndërtesa ofron njohuritë themelore të nevojshme për të vlerësuar se si përdoret energjia në një objekt dhe për të identifikuar se ku mund të reduktohet konsumi. Për më tepër, ai mbulon metodologjitë e dobishme të llogaritjes përmes shembujve praktikë dhe skenarëve të mundshëm kompjuterik. Gjithashtu ben qe sistemi I ndricimit te zgjidhet teknologjia e LED. Po ashtu edhe ne termoizolimim e fasades duke zgjedhur dhe perlllogaritur materialet me matjet e bera ne vend te muratures ekzistuese percjellshmerise se saj termike edhe perlllogaritur ne projektin e ri specifikat e sisptemit kapot me te pershtatshmet per reduktimin e energjise gjate periudhes me temperature minimale dhe maksimale te vitit, dhe mbuleses duke reduktuar disa fish konsumin e energjise.

Referuar punonjësve të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,dhe punonjës i pajisur me certifikatë për përgjegjës dhe administrimin e mbrojtjes në mjedis AK garanton ne kete menyre se do te realizohet plani i organizimin te mbejeve, metodologjine e prishjeve dhe reduktimin te pluhrave me teknikat me uje, ndotjes akustike dhe rrethimit te kaniterit, ngritjes se tij duke qene se nddhet ne nje zone te banuar me nje numer te larte banoresh dhe institucinet perreth.

Referuar inxhinierit gjeoteknik nevojitet per te realizuar strukturat mbajttese dhe mbrojttese te dheut,te gjitha llojet e themeleve,permiresim bazamentesh, etj.

Referuar eksperteve zjarrfikese nevojitet per planifikimin dhe projektimin e sitemeve kundra zjarrit dhe vendosjen e tyre ne vende te caktuara ne objekt .

Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar Termave te References. Kriteri për stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e ndertimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Për kryerjen e punimeve në objekt, OE pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë të paktën 70 (shtatedhjetë) punonjës per muajt mars-prill-maj 2023, nga këta sipas llogaritjes së numrit të punonjësve 53 janë personel punëtor dhe 17 staf teknik (inxhinierë + mjek etj) drejtues teknik.

(1) vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar;

(2) listëpagesat e deklaruar ne organet tatimore bazuar në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare te profesioneve” për periudhën e kërkuar me sipër.

Me anë të një deklarate të nënshkruar nga Administratori i shoqërisë, OE pjesëmarrës duhet të përcaktojë “Përgjegjësin teknik të kantierit”, ku të theksohet që: “Përgjegjësi teknik i kantierit do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në asnjë kontratë tjetër përveç kontratës objekt prokurimi nga AK”. Përgjegjësi teknik i kantierit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Shënim: Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8 ku të deklarohet disponimi i mjeteve

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c dhe 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Bazuar në parashikimet e legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.
- Kërkesa specifike për Inxhinierët dhe Arkitektët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.
- Inxhinieret kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Gjithashtu dhe arkitektët, të cilët duhen dy për shkak se objekti i prokurimit përfshin disa ndërhyrje duke filluar nga rehabilitimit fasadës rikonstruksioni dhe përshtatja e ambienteve të gjithë godinës, sistemimet e jashtme me gjelbërim, trotuare, rrugë etje dhe rikonstruksioni i fasadës së objektit.
- Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafit i inxhinierëve, është përcaktuar nga

pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- Me qëllim që punimet e ndërtimit të realizohen nga ana e operatorit ekonomik, në zbatim të rregullave të sigurimit teknik detyrimisht kërkohej një staf teknik i specializuar. Ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku citohet “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.
- Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP - 1, NP - 2, NP – 3, NP – 4, NS - 1, NS - 4, është e nevojshme prezenca e Arkitektit dhe Inxhinierit të Ndërtimit (Strukturist). Në këto veper parashikohet përforcimi themelit me betonarme dhe përforcimi i mureve me shtresë betoni dhe zgarë, gjithashtu ndërtimi i një shtesë beton arme, rikonstruksioni i fasadës.

Inxhinierit Hidroteknik. Parashikohet ndërtimi i rrjetit uji i ngrohtë dhe uji i ftohtë i pasijur me aparate sanitare dhe rrjeti i shkarimit t ujërave të zeza bashkënduar me kategorine e licensës N.S - 2 .

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NP - 11, NS - 14 është e nevojshme prezenca e Inxhinierit Elektrik. Në këto veper një pjesë të rëndësishme zene punimet për instalimet elektrike.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS -18 është e nevojshme prezenca e një Inxhinier Gjeodet/Topograf/, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS – 12, është e nevojshme prezenca e Inxhinier Mekanik, pasi kjo veper parashikon realizimin e sistemeve HVAC dhe tubacioneve.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës NS – 13, NS - 14 është e nevojshme prezenca e Inxhinier Elektronik/Informatik/Telekomunikacion pasi kemi punime në sistemin e monitorimit/vëzhgimit CCTV dhe sistemin telefonik dhe kompjuterik si edhe sistemin zanor.

- Referuar në preventivin e punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës N.P - 12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit” është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Mjedisit.

- Inxhinier/Arkitekt ekspert i certifikuar nga AEE për eficientësinë e energjisë, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në licencën N.S – 4 që ka të bëjë me punimet e rifiniturës të cilat përfshijnë zërat për rritjen e performancës së energjisë në strukturat që do të nënshtrohen rikonstruksionit dhe vendosjes së sistemeve HVAC dhe sistemeve të furnizimit me energji dhe furnizimit me ujë të ngrohtë, nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ligjin Nr. 124/2015 “Për Eficientësinë e Energjisë” dhe Ligjin Nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa”.

· Eksperti zjarrefiks

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje të plotë me Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, Neni 77, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, pika 6/ç, si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për kërkesat teknike “Për mbrojtjen kundra zjarrit” në ndërtesat publike.

Është arsyetuar e nevojshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës vendosja e kësaj kërkesë për operatorin ekonomik pasi në procesin e ndërtimeve të rikonstruksioneve dhe përshtatjeve të objekteve, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë pjesë të stafit të certifikuar ekspert të trajnuar për mbrojtjen kundra zjarrit me qëllim ndjekjen e zbatimit të normave dhe rregullave në lidhje me ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa. Në Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri", i ndryshuar, citohet: *“Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta”*.

Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi, si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyrues, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në ndërtimet e reja, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të jetë i licencuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Kategoria I.2.A “Shërbime ekspertize” specifikon shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit.

- **Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**

Ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 6/ç, si dhe në zbatimin e nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për

sigurinë dhe shëndetin në punë” ku citohet..... “*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion*”, si dhe VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”. Ky kriter ka si qëllim të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë nga operatori ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, formimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre.

Punëdhënësit janë të detyruar të ndjekin rregulla të përgjithshme të parandalimit të rrezikut duke mbajtur parasysh natyrën e veprimtarisë së ndërmarrjes/institucionit; vlerësimin e rrezikshmërisë ndaj sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve.

Specialisti për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë duhet të jetë një profesionist, i cili harton planin e sigurisë dhe të koordinimit në kantier, parapërgatit një dosje, e cila përmban informacionet e nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar punëtorët, harton planin operativ të sigurisë, kryen mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve.

- **Eksperti i mjedisit**

Qëllimi për vendosjen e këtij kriteri është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve. Vlerësimin e ndikimeve negative mjedisore në kohën e duhur dhe parandalimin e tyre.

Në pikën 4, Nenin 24 të ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis” përcaktohet se licencat e këtyre ekspertëve përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor.

- **Manovratorët eskavatorist, makinist etje.**

Përcaktimi i këtij kriteri është bërë referuar objektit të prokurimit si dhe volumit të punimeve si dhe zerave të përcaktuara në preventiv në baze të mjeteve dhe makinerive të kerkuara.

- **Punësimi mesatar**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku citohet “*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose*

enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar referuar volumeve të punës që do të kryhen, afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi, si dhe grafikut të punimeve të percaktuar nga autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshëm për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve dhe grafikut të punimeve.

- **Teknikët dhe punonjësit e specializuar/të kualifikuar**

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuar në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional

Operatori/ët ekonomik, të vetëdeklarojnë sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (*shtojca 8*), për mjetet dhe pajisjet si më poshtë:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
2.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 toN	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
3.	Kamioncina 1.5 deri 2 ton	Në pronësi ose me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
4.	Kamioncina 3.5 deri 5 ton	Në pronësi ose me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
5.	Eskavator me goma	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
6.	Kamion me vinç	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
7.	Rimorkiator për transportin e mjeteve	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
8.	Fadromë kovë para dhe mbrapa	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
9.	Eskavator me zhinxhir	në pronësi ose me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
10.	Minieskavator	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
11.	Rul ngjeshës	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
12.	Autobetoniere	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
13.	Autopompë	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
14.	Gjeneratorë mbi 50 kva	Në pronësi/me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
15.	Autobetoniere me kapacitet 2.5 – 3 m ³	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
16.	Vibrator betoni	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	3
17.	Matrapik	Në pronësi ose me qera	Copë	2
18.	Depozita Uji 5000 L	Në pronësi ose me qera	Copë	1
19.	Nivelues Helikopter	Në pronësi, me qera ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
20.	Kthyese Hekuri-Bango hekuri	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	2
21.	Kontenjer (zyre)	Në pronësi, me qera, ose kontratë bashkëpunimi	Copë	1
22.	Elektro saldatriçe	Në pronësi ose me qera	Copë	1

23	Grejder me targa	Në pronësi ose me qera	Copë	1
----	------------------	------------------------	------	---

24	Skela	Në pronësi ose me qera	M2	1800
25	Armaturë/betoforma/lendë drusore	Në pronësi ose me qera	M2	1000
26	Prerëse pllakash	Në pronësi ose me qera	Copë	2
27	Gazogjen	Në pronësi ose me qera	Copë	2
28	Pompë suvatimi	Në pronësi ose me qera	Copë	2
29	Platformë ngritëse për lartësi	Në pronësi ose me qera	Copë	1
30	Impliant prodhim betoni me QKL	Në pronësi, me qera, ose kontratë furnizimi	Copë	1

Ky dokumentacion, përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas *Shtojcës 8 të DST-së*.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

A. Për mjetet në Pronësi që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Policë për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.
5. Çertifikata e transportit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR.

B. Për mjetet me Qera që shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Çertifikatë mbi Pronësinë e mjetit rrugor, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
2. Leje qarkullimi, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
3. Çertifikata e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të vlefshme, lëshuar nga D.P.SH.T.RR.
4. Policë për sigurimin e detyrueshëm ndaj palëve të treta (T.P.L.), të vlefshme, lëshuar nga njëra prej Kompanive të Sigurimit që operojnë në tregun shqiptar.
5. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.
6. Çertifikata e transportit për të tretë ose në emër të qeramarrësit lëshuar nga Bashkia ose D.P.SH.T.RR.

C. Për mjetet në Pronësi që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore e blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara.

D. Për mjetet me qera që nuk shënohen në Rregjistra Publikë, duhet të paraqiten:

1. Fatura tatimore të blerjes, akt çdoganimi për mjetet e importuara;
2. Kontrata përkatëse e qerasë, e vlefshme për të paktën periudhën e zbatimit të Kontratës.
3. Për impiantin e prodhimit të betonit të paraqiten dokumentat e pronësisë ose kontratën e qerasë/kontrata e furnizimit shoqëruar si më poshtë:
4. -QKL-Leje Mjedisi të tipit B, Kodi:III.1.B “Për impiant betoni, prodhimin e produktve të betonit, shoqëruar me planvensodjen për impiantin.

Është e mjaftueshme paraqitja e vetëdeklarimit *sipas Shtojcës.8 të DST-së*.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

Numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve. Gjithashtu në referencë të frymës së ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht të nenit 77, pika 4, i cili përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, në zbatim të gjithë legjisllacionit në Republikën e Shqipërisë, lidhur me ambientin.

Standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

· Certifikatë ISO 9001 - 2015 (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;

· Certifikatë ISO 45001 - 2018 (ose e përditësuar) mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;

· Certifikatë ISO 14001 - 2015 (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;

· Certifikatë ISO 50001 - 2011 (ose e përditësuar) mbi “Sistemin e menaxhimit të energjisë” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, dhe nenin 79 të LPP, nenin 39, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha certifikata e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Legjislacioni në fuqi për prokurimin publik i jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të kërkojnë certifikime nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar, në mënyrë që të vërtetojnë se punët që kërkohet të realizohen nga operatorët ekonomik, do të jenë sipas kërkesave të cilësisë.

Kriteri i vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, i cili përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. Që të realizohet me cilësi dhe konform standarteve procedura, objekt prokurimi, operatori duhet të jetë i çertifikuar me certifikatat ISO të menaxhimit si më sipër, të cilat në rastin konkret vlerësohen të nevojshme përsa i përket cilësisë dhe sigurisë në punë. Pra konsiderohet si kriter i lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet dhe i bazuar në LPP.

Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe certifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit shëndetit dhe sigurisë në punë

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 50001-2011 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e energjisë.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale elektrike
- Materialet hidraulike
- Materialet e rrjetit ngrohes (HVAC)
- Materialet e sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit (MNZ)
- Materiale durale
- Materiale hidroizoluese
- Materiale termo-izoluese (Sistem Kapote)

- Pajisje hidrosanitare
- Pllaka, Parket, Laminat
- Bojra

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin dhe katalogun perkates. Operatori duhet te paraqese deklarate me shkrim qe jep garanci 1 vjecare per mallrat ne kete procedure

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, dhe nenin 79 të LPP, nenin 39, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku AK kërkon që të garantohet për cilësinë e materialeve, pjesëve dhe pajisjeve që do të përdoren dhe vendosen në objekt, duke kërkuar të paraqes autorizim prodhuesi, marrëveshje bashkëpunimi, autorizim distributori dhe deklarata konformiteti.

NJËSIA E PROKURIMIT

Julinda Karteri person pergjegjes

Maksim Shehu antar

Sibjon Çobaj antar